

**OPERATORI I KOMBINUAR I GAZIT NATYROR
ADMINISTRATORI**

Nr. 111 Prot.

Tiranë, më 27/02/2026

VENDIM

Nr. 51, datë 27/02/2026

MBI

**MIRATIMIN E REGJISTRIT TË RISKUT DHE STRATEGJISË SË
MENAXHIMIT TË RISKUT**

Në zbatim ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, dhe Statutit të shoqërisë "Albgaz" SH.A, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 848, datë 07.12.2016, për "Krijimin e Shoqërisë "Albgaz" SH.A, dhe për caktimin e Autoritetit Publik që përfaqëson Shtetin si pronar të aksioneve të Shoqërive Albpetrol SH.A dhe Albgaz SH.A", i ndryshuar me VKM Nr.108, datë 23.02.2018:

VENDOSA:

1. Miratimin e Regjistrit të Riskut dhe Strategjisë së Menaxhimit të Riskut të shoqërisë "Albgaz" SHA, bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Strategjia e Menaxhimit të Riskut të publikohet në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë.
3. Strukturat përgjegjëse GMS dhe GMR të marrin masat për përditësimin e regjistrit të riskut dhe zbatimin e strategjisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ADMINISTRATORI ALBGAS SH.A.

Sh.a.
Amarda KAPAJ





STRATEGJIA E MENAXHIMIT TË RISKUT

ALBGaz SH.A

Shkurt, 2026

Përmbajtja

I. Hyrje.....	3
II. Përkufizime dhe përcaktime	4
III. Risku, çfarë do të thotë dhe si menaxhohet.....	5
IV. Roli dhe përgjegjësia menaxheriale në Albgaz	5
V. Deklarata e politikës së menaxhimit të riskut	6
VI. Qëllimi i politikës së menaxhimit të riskut.....	7
VII. Parimet e menaxhimit të riskut	7
VIII. Komponentët e menaxhimit të riskut	9
IX. Strategjia e menaxhimit të riskut, fushat kryesore.....	13
X. Objektivat e përgjithshme të Albgaz.....	13
XI. Plani i veprimit për minimizim të riskut.....	15

I. Hyrje

Ky dokument përcakton parimet e përgjithshme të menaxhimit të riskut duke menaxhuar risqet në vendimmarrje, vendosjen dhe arritjen e objektivave dhe përmirësimin e performancës.

Dokumenti përcakton standartet që duhen përdorur në procesin e kontrollit të shërbimeve me qëllim që të arrihet një përdorim më eficient i burimeve dhe rezultate sa më optimale në kontrollin e zbatimit të kuadrit ligjor të menaxhimit financiar.

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme që kanë efekt të dëmshëm mbi përmbushjen e objektivave dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këto objektiva do të realizohen.

Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes. Identifikimi dhe menaxhimi i riskut mundëson strukturat drejtuese në çdo njësi në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive që kanë për realizimin e aktivitetit në to. Çdo drejtues është i vetëdijshëm se risku do të ekzistojë dhe nuk do të eliminohet kurrë tërësisht. E rëndësishme është që risku të menaxhohet në mënyrë efektive.

Pjesë përbërëse është edhe vlerësimi sasior dhe cilësor i mekanizmave të kontrollit, raportimeve dhe proceseve për adresimin e risqeve të ndryshëm duke dhënë detaje për metodologjinë e mënyrat specifike të trajtimit të çdo tip risku.

Në mënyrë të veçantë lloje të ndryshme risqesh drejtohen nga faktorë të ndryshëm risku ndaj dhe aspektet organizative, proceset e tyre shpjegohen në mënyrë të detajuar duke përfshirë dhe alokimin e përgjegjësive, proceset operationale si dhe skedulet dhe mjetet e sistemit të raportimit.

Menaxhimi i riskut është pjesë e drejtimit dhe është thelbësor për mënyrën se si institucioni menaxhohet në të gjitha nivelet. Menaxhimi i riskut është faktor kontribues në përmirësimin e sistemeve të menaxhimit duke qenë pjesë e të gjitha aktiviteteve që lidhen me një institucion dhe përfshin ndërveprimin me palët e interesuara.

**Ky dokument (Strategjia e menaxhimit të riskut) është hartuar në përmbushje të detyrimit ligjor dhe përgjegjësive të koordinatorit të riskut, të cilat janë të përcaktuara në Ligjin nr 10296 datë 08/07/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar nga Ligji 14 datë 16.02.2023.*

II. Përkufizime dhe përcaktime

- "Risku"- është efekti i pasigurisë në arritjen e objektivave dhe mund të shoqërohet me pasojat të cilat mund të jenë avantazhuese ose dizavantazhuese në varësi të situatës apo ngjarjes.
- "Vlerësim i Riskut" - Proçesi i krahasimit të rezultateve të analizës së riskut me kriteret e riskut, për të përcaktuar nëse risku dhe/ose madhësia e tij, janë të pranueshëm, ose të tolerueshëm.
- "Zotëruesi i Riskut" - është personi brenda një njësie organizative, i cili ka autoritetin dhe është përgjegjës për administrimin e riskut, brenda njësive të tij.
- "Zotëruesi i Proçesit" - është personi, i cili ka përgjegjësinë parësore për kryerjen e një proçesi, në realizimin e objektivave të tij të matura përmes treguesve kryesorë të proçesit, dhe ka autoritetin dhe aftësinë për të bërë ndryshimet e nevojshme.
- "Politikë" - jep parimet bazë që udhëheqin institucionin, për çështje apo situata të ngjarjeve specifike. Këto parime përdoren si guidë gjatë vendim-marrjeve të caktuara.
- "Probabiliteti" është shansi që diçka mund të ndodhë. Ai mund të përcaktohet, vendoset apo matet në mënyrë objektive, ose subjektive, dhe mund të shprehet ose në mënyrë cilësore, ose sasiore (duke përdorur modele matematikore).
- "Palë e Interesuar" - Një person apo një organizatë që mund të ndikojë apo mund të ndikohet nga një vendim apo një aktivitet.
- "Risk i Mbetur" - është Risku që mbetet pasi është implementuar një mënyrë e trajtimit/adresimit të tij, është eliminuar/neutralizuar burimin e Riskut, janë modifikuar pasojat e Riskut, është ndryshuar probabiliteti, është transferuar ose është mbajtur Risku.
- "Risku i qënësishëm/i pandashëm" - Në standartet ndërkombëtare ISO 31000 risku i qënësishëm i referohet kryesisht në kontekstin kontabël materializimit të një risku për të cilin nuk ka ose nuk mund të ndërtohen sisteme kontrolli. Përcaktimet e këtij lloji risku janë gjithashtu:
 - 1) Risku është prezent si rezultat i ambientit/industrisë/sektorit në të cilën operon institucioni;
 - 2) Risk që nuk mund të menaxhohet apo transferohet;
 - 3) Nivel risku jashtë çdo kontrolli nga ana e institucionit;
 - 4) Risqet që lidhen me "forcat madhore"; përmbytje, zjarr, luftë etj.
- "Strategji risku" - Strategjia e riskut përshkruan strukturën organizative të institucionit, planin e zhvillimit strategjik dhe atë të rritjes së aktivitetit të shoqërisë. Ajo përcakton politika specifike të menaxhimit të riskut, vendos një kuptim të përbashkët të të gjitha hallkave drejtuese në lidhje me objektivat e menaxhimit të riskut që do të thotë është një guidë bazë për menaxhimin dhe kontrollin e riskut shoqëri. Këto politika përkufizojnë profilin e riskut që shoqëria merr përgjithësisht (ose shmang) dhe shpjegojnë nivelin e "synuar" të tij (*risk appetite*) të shprehur dhe në buxhet në formën e nivelit të provigjioneve të planifikuara, nivelit të fitimit të parashikuar etj.

- “Vlerësimi i riskut” - është analiza në lidhje me nivelin e efektit në vlerë që ka çdo tip risku në performancën e shoqërisë dhe nëse ky efekt është material apo jo material.
- “Metodologjia e menaxhimit të riskut” - Përcakton format dhe nivelin e teknikave të kontrollit dhe menaxhimit për çdo tip risku

III. Risku, çfarë do të thotë dhe si menaxhohet

Risku është probabiliteti i ndodhjes së një ngjarje të caktuar që do të kishte ndikim në përmbushjen e objektivave të një institucioni. I parë më me hollësi nga studiuesit, risku ka dy drejtime matjeje:

1. Nga mundësia e ndodhjes.
2. Nga impakti që sjell.

Menaxhimi i riskut është puna më domethënëse dhe më frytdhënëse në hartimin e dokumenteve zyrtare të një institucioni. Në Albgaz ky dokument përcakton një sërë parimesh dhe rregulla të cilat përdoren ose vihen në zbatim për të pasur nën mbikqyrje riskun i cili ndikon në mosarritjen e objektivave.

Menaxhimi i riskut në vetvete do të thotë të identifikosh, vlerësosh dhe kontrollosh ato situata të cilat ndikojnë negativisht në arritjen e objektivave të drejtorive. Nisur nga sa thamë menaxhimi i riskut mund të quhet ndryshe një **agjent** i objektivave të institucionit. Agjent, i cili zbulon, identifikon, mbikëqyr riskun që i dëmton arritjen e objektivave. Për të zbatuar veprimtaritë që lidhen me riskun dhe menaxhimin e tij titullari i njësisë miraton një strategji e cila hartohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore në mjedisin e riskut.

IV. Roli dhe përgjegjësia menaxheriale në Albgaz

(sipas ligjit nr.10296 datë 08.07.2010)

A. Ministria është autoriteti përgjegjës për futjen e një sistemi të efektshëm të menaxhimit të riskut si pjesë e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik.

B. Nëpunësi i parë autorizues është përgjegjës për monitorimin e sistemit të menaxhimit të riskut.

C. Titullari i Albgaz është përgjegjës për hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e strategjisë së menaxhimit të riskut. Gjithashtu ai mban përgjegjësi për përcaktimin e atyre risqeve që mund të tolerohen, shmangen ose parandalohen.

Ç. Koordinatori i riskut në Albgaz është titullari i shoqërisë, i cili është përgjegjës për një sërë aktiviteteve:

- Bashkërendon veprimtaritë që lidhen me identifikimin e risqeve, vlerësimin e tyre si dhe menaxhimin në mënyrë sa më të mirë për të mos vënë në rrezik arritjen e objektivave.
- Këshillimin dhe dhënien e instruksioneve menaxherëve të tjerë të njësive në varësi të shoqërisë në bashkëpunim me Drejtorinë.
- Përgatitja dhe paraqitja e raportit të përgjithshëm të menaxhimit të risqeve në Albga sh.a dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik.
- Monitorimi i kontrollit të risqeve që vënë në rrezik objektivat e Shoqërisë.

D. Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS).

Vepron si një strukturë më vetë ngritur brenda shoqërisë ku diskutohen çështjet kryesore të Shoqërisë. Ky grup mbledhet të paktën katër herë në vit dhe diskuton përveç të tjerave dhe problemet e menaxhimit të riskut.

GMS studion problematikat më të rëndësishme të Shoqërisë; verifikon se si janë menaxhuar risqet dhe përgatit një raport vjetor; shqyrton regjistrin e riskut të shoqërisë duke vlerësuar se si janë gjykuar risqet, a janë identifikuar si duhet; përmirëson proceset e menaxhimit financiar dhe kontrollit nëpërmjet studimeve dhe diskutimeve të pjesëtarëve të GMS.

Koordinatori i menaxhimit të riskut duhet të raportojë çdo problem të GMS–ja. Drejtuesit e drejtorive monitorojnë dhe kontrollojnë mjediset e tyre. Ata evidentojnë risqet dhe u raportojnë për këtë koordinatorit të riskut. Për çdo ndryshim në drejtori, drejtuesit e tyre duhet të raportojnë koordinatorin e riskut të Shoqërisë.

Regjistri i riskut i çdo drejtorie duhet të shqyrtohet dhe të merret në konsideratë nga GMS–ja. Drejtori i Auditit merr pjesë në çdo mbledhje të GMS –së pa të drejtë vendimmarrje.

E. Menaxherë të tjerë të shoqërisë janë drejtorët e tjerë të shoqërisë të cilët nuk janë pjesë e GMS-së. Ata janë drejtues dhe si të tillë janë përgjegjës për identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut. Menaxherët vlerësojnë dhe kontrollojnë risqet që ndikojnë negativisht në arritjen e objektivave, monitorojnë veprimtarinë e strukturave që ata drejtojnë.

F. Njësia qendrore e harmonizimit për menaxhimin financiar dhe kontrollit.

Është përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit dhe funksionimit të sistemit të menaxhimit të riskut si dhe për këshillimin dhe udhëzimin.

G. Audituesit e brendshëm të shoqërisë duhet të shqyrtojnë në fund të vitit gjithë procesin për menaxhimin e riskut, i sugjerojnë kryetarit për fushat ku ka nevojë për përmirësim si dhe ndihmojnë menaxherin e njësive për problemet e ndryshme.

V. Deklarata e politikës së menaxhimit të riskut

**ALBGAZ SH.A NËPËRMJET KËSAJ STRATEGJIE, ANGAZHOHET TË SIGUROJË
QË RREZIQET IDENTIFIKOHEN DHE TRAJTOHEN ME PËRGJEGJËSI TË
PËRCAKTUAR DHE NË KOHËN E DUHUR.**

Në përmbushje të kësaj deklarate, detyrimet që lidhen me realizimin e politikës së menaxhimit të riskut janë:

- Detyrim i drejtuesve të njësive të veçanta dhe programeve për monitorimin dhe verifikimin periodik të risqeve që kërcënojnë realizimin e qëllimeve kryesore strategjike.
- Personat përgjegjës për menaxhimin e riskut duhet të kenë kualifikimin e nevojshëm për të identifikuar riskun, për monitorimin, vlerësimin dhe adresimin e tij.
- Punonjësit kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin, analizën dhe
- Çdo veprim i punonjësit i cili ka për qëllim marrjen përsipër të përgjegjësisë për riskun do të mbështeten nga drejtuesit.
- Raportimi për çdo lloj ngjarje, si pozitive, ashtu dhe negative është detyrim i çdo punonjësi.
- Me qëllim garantimin e realizimit të politikës së menaxhimit të riskut, vendoset procedura në kuadër të strategjisë së menaxhimit të riskut.

VI. Qëllimi i politikës së menaxhimit të riskut

Qëllimi i politikës së menaxhimit të riskut është identifikimi i fushave të riskut, vlerësimi i riskut dhe më tej eliminimi, apo reduktimi i riskut në një nivel të pranueshëm duke kufizuar kostot shoqërore dhe financiare në minimumin e domosdoshëm.

Menaxhimi i riskut institucional lidhet me rreziqet dhe mundësitë që ndikojnë në krijimin e vlerave ose ruajtjen e vlerave. Menaxhimi i riskut nuk është një proces linear, por ai është balancimi i një numri të elementeve të ndërthurur që ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe të cilat duhet të jenë në ekuilibër me njëri-tjetrin me qëllim që menaxhimi i riskut të jetë efektiv. Për më tepër, risqet specifike nuk mund të trajtohen në mënyrë të izoluar nga njëri-tjetri, menaxhimi i një prej risqeve mund të ketë një ndikim në një tjetër, apo veprimet e menaxhimit të cilat janë të efektshme në kontrollin e më shumë se një risku në të njëjtën kohë, mund të jetë i arritshëm.

VII. Parimet e menaxhimit të riskut

Parimet e menaxhimit të riskut mbështeten në pesë komponentë të menaxhimit financiar dhe kontrollit sipas standardeve ndërkombëtare COSO dhe INTOSAI, ku vetë komponentët përfshijnë disa parime si më poshtë vijojnë:

1. Mjedisi i kontrollit

Parimi 1 - Njësia Publike demonstroi angazhim për integritet dhe vlerat etike. Menaxherët e nivelit të lartë të njësisë publike, shprehin dhe demonstrojnë rëndësinë e integritetit dhe vlerave etike në të gjithë njësinë.

Parimi 2 – Titullari / Nëpunësi Autorizues (NA) / Bordi apo Këshilli i Drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje. Organi mbikëqyrës (Titullari / Nëpunësi Autorizues / Bordi apo Këshilli i drejtuesve në varësi të llojit të njësisë) demonstroi pavarësi në ushtrimin e detyrave dhe ushtron mbikëqyrje për zhvillimin dhe performancën e kontrollit të brendshëm.

Parimi 3 – Titullari / Nëpunësi Autorizues (NA) krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë. Titullari / NA i njësisë publike duhet të krijojë një strukturë organizative, të caktojë përgjegjësi dhe të delegojë përgjegjësitë përkatëse për të arritur objektivat e njësisë, duke mirëpërcaktuar gjithashtu edhe linjat e raportimit.

Parimi 4 -Njësia publike demonstroi angazhim në realizimin e kompetencave. Njësitë publike demonstrojnë një angazhim për të tërhequr, zhvilluar dhe mbajtur personel kompetent në përputhje dhe në mbështetje të objektivave të njësisë.

Parimi 5 -Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale. Njësia publike duhet të ketë personel të përgjegjshëm në realizimin e përgjegjësisë në lidhje me kontrollin e brendshëm dhe më konkretisht në ndjekjen e objektivave të njësisë.

2. Menaxhimi i riskut

Parimi 6 – Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve në lidhje me këto objektiva. Përcaktimi i objektivave të njësisë publike është formimi i bazës mbi të cilën zbatohet vlerësimi i riskut dhe krijohen aktivitetet pasuese të kontrollit. Titullarët / NA / Menaxherët përcaktojnë objektivat dhe i grupojnë ato në kategori më gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet e njësisë, në lidhje me aktivitete, raportimet dhe pajtueshmërinë.

Parimi 7 – Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave. Njësia publike identifikon risqet për arritjen e objektivave të saj në të gjithë njësinë dhe analizon risqet si bazë për të përcaktuar më pas se si duhet të menaxhohen risqet.

Parimi 8 – Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut të mashtrimeve. Njësia publike merr parasysh dhe vlerëson mundësinë e mashtrimit në vlerësimin e riskut për arritjen e objektivave.

Parimi 9 - Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet e rëndësishme. Njësia publike identifikon dhe vlerëson ndryshimet që mund të ndikojnë ndjeshëm në sistemin e kontrollit të brendshëm.

3. Aktivitetet e kontrollit

Parimi 10 – Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit. Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit që kontribuojnë në zbutjen e risqeve për arritjen e objektivave në nivele të pranueshme.

Parimi 11 - Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë. Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë për të mbështetur arritjen e objektivave.

Parimi 12 – Njësia Publike vendos aktivitete kontrollit përmes politikave dhe procedurave. Njësia publik vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave që përcaktojnë se çfarë pritet dhe procedurat që vënë në veprim politikat.

4. Informimi dhe komunikimi

Parimi 13 - Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacionin përkatës cilësor. Njësia publike merr ose gjeneron dhe përdor informacion të rëndësishëm, cilësor për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Parimi 14 - Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm. Njësia publike komunikon në mënyrë të brendshme informacionin, duke përfshirë objektivat dhe përgjegjësitë për kontrollin e brendshëm, të nevojshëm për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Parimi 15 - Njësia Publike përdor komunikimin e jashtëm. Njësia publike komunikon me palët e jashtme lidhur me çështjet që ndikojnë në funksionimin e kontrollit të brendshëm.


5. Monitorimi

Parimi 16 - Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe / ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm. Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe / ose të veçanta për të konstatuar nëse komponentët e kontrollit të brendshëm janë të pranishëm dhe funksionojnë.

Parimi 17 - Njësia Publike vlerëson dhe komunikon mangësitë. Kur identifikohen mangësitë e kontrollit të brendshëm, titullari i njësisë publike duhet të ndërmarrë veprimet korrigjuese dhe t'i komunikojë ato në nivelin e duhur dhe në kohën e duhur

VIII. Komponentët e menaxhimit të riskut

Që të mund të hartohet një menaxhim risku efektiv, hapi kryesor është njohja e situatës së Albgaz në disa drejtime. Hapi i parë dhe më i rëndësishëm i strategjisë së menaxhimit të riskut është identifikimi fillestar i riskut dhe përcaktimi i drejtë i ndikimit të tij në objektivat e shoqërisë.



Komponentët e menaxhimit të riskut janë:

A. Identifikimi i riskut.

Së pari risku duhet të identifikohet nga vjen risku, nga burime të brendshme apo të jashtme.

Risku që vjen **nga burime të jashtme**. Këtu mund të përfshihen ndryshimet në dispozitat ligjore p.sh. ligji për gazin natyror, kushtet ekonomike etj. Ky risk quhet i jashtëm.

Risku që vjen **nga burime të brendshme**. Këtu mund të përfshihen ndryshimet në staf, çështjet buxhetore etj.

B. Dokumentimi i riskut

Gjithë puna që realizohet për menaxhimin e riskut duhet dokumentuar. Për këtë hartohet një regjistër risku i cili ka formatin e vet të përcaktuar në ligj. Regjistri i riskut publikohet dhe duhet të jetë i disponueshëm për të gjithë stafin.

C. Vlerësimi i riskut (Analiza)

Drejtorët e drejtorive të shoqërisë (menaxheret e të gjitha niveleve) duhet të identifikojnë risqet në drejtim të mundësisë **së ndodhjes dhe ndikimit** mbi objektivat.

Mundësia që risku të ndodhë lidhet me probabilitetin që ngjarja e pafavorshme të ndodhë, nëse nuk ka aktivitete kontrolli që do ta parandalonin apo zvogëlonin riskun. Kjo do të matet me tri shkallë (i lartë, i mesëm, i ulët).

Ndikimi është efekti që ngjarja e padëshirueshme do të kishte mbi objektivat e shoqërisë, nëse do të ndodhte vërtet. Për këtë, efekti duhet përlogaritur në formën sasiore dhe të përshkruhet në mënyrë konkrete që të tregojë rëndësinë e riskut. Ndikimi duhet të vlerësohet në tre shkallë (i lartë, i mesëm, i ulët).

Vlerësimi i secilit risk duhet të bëhet të paktën një herë në vit dhe mbase më tepër, varet nga rëndësia e riskut dhe ndikimi i tij në objektivat.

Gjatë vlerësimit të riskut duhet marrë parasysh **raporti i kostos** për aktivitetin e kontrollit që do të ndërmerret ndaj përfitimeve, lidhur me reduktimin e riskut.

Ndikimi i riskut si dhe mundësia e ndodhjes krijojnë një matrice 3x3 e cila paraqet risqet e mbetura pas reduktimit të bërë nga kontrollet ekzistuese.

IMPAKTI	E lartë			
	E mesme			
	E ulët			
		E ulët	E mesme	E lartë
PROBABILITETI				

Analiza dhe vlerësimi i riskut është një proces i cili kërkon një vëmendje të veçantë sidomos në proceset të cilat janë prioritet i shoqërisë. Risqet që vijnë nga proceset më me prioritet quhen risqe me prioritet të lart (risqe kyç).

Risqet e identifikuar në Albga (të brendshëm dhe të jashtëm) u përkasin drejtorive si më poshtë:

1. Drejtoria e Financës, Kontabiliteti dhe Programimit.
2. Drejtoria Tregtare dhe e Marrëdhënieve Rregullatore
3. Drejtoria Juridike dhe e Prokurimeve
4. Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse
5. Drejtoria e Projekteve dhe Marrëveshjeve
6. Drejtoria Teknike

D. Adresimi i riskut, reagimi dhe trajtimi i riskut.

Gjithë puna e hartuar për strategjinë e menaxhimit të riskut fokusohet të reagimi i tij. Reagimi i riskut do të jetë **tolerimi ndaj tij, trajtimi i tij, transferimi i tij dhe/ose përfundimi i tij**. Përpunimi përfundimtar do të regjistrohet në regjistrin e riskut.

Të menaxhosh riskun do të thotë të marrësh masat për të ulur mundësinë e ndodhjes së këtyre risqeve, deri në bërjen zero të tij.

Trajtimi me qëllim kufizimin ose pakësimin e riskut.

Dihet që risku të shmanget ose shuhet plotësisht ndodh shumë rrallë. Për këtë arsye duhen planifikuar aktivitete kontrolli të cilat shërbejnë si garanci që risku të pakësohet në parametra të pranueshëm. Risku që trajtohet në këtë formë duhet monitoruar rregullisht.

Transferimi i riskut.

Menaxhimi i riskut në Albgaz mund ta etiketojë riskun e një objektivi si shumë të lart dhe që duhet transferuar në njësi tjetër (nga njëra drejtori në tjetrën). Mënyra më e njohur për transferimin e riskut është sigurimi (siguracion risku). Por për këtë ka një kosto shtesë. Megjithëse rezultati do të jetë i dukshëm, kosto e këtij rezultati do të jetë shumë e lart dhe kjo do të sjellë gjetjen e mënyrave të tjera të transferimit të riskut.

Tolerimi i riskut.

Grupi i menaxhimit të riskut në Albgaz përcakton se disa risqe kanë ndikim të papërfillshëm në qëllimet dhe objektivat e shoqërisë. Në këto raste reagimi ndaj riskut do të ishte tolerimi. Por kjo nuk do të thotë që vëmendja e menaxhereve të largohet nga këto risqe. Ekziston mundësia që këto risqe të bëhen më të rrezikshëm në ndikimin e tyre në arritjen e objektivave. Pra duhen pasur gjithë kohës nën vëmendjen e menaxhereve.

Aktivitetet e kontrollit

Një procedurë tjetër e cila mund të ndihmojë në situatat e riskut është **nëpërmjet kontrolleve** të ushtruara nga zyra e auditimit në Albgaz. Llojet e kontrolleve janë:

1. **Kontrolle parandaluese** të konceptuara për të reduktuar mundësinë që risku të ndodhë.
2. **Kontrolle korrigjuese** të projektuara për të korrigjuar rezultatet e padëshiruara.
3. **Kontrolle drejtuese** të projektuara për të garantuar arritjen e një rezultati të përcaktuar.
4. **Kontrolle zbuluese** të projektuara për rastet kur rezultatet e padëshiruara kanë ndodhur.

Të gjitha llojet e kontrolleve shoqërohen me kosto dhe është e rëndësishme që kosto të justifikohet me përfitimet, pra duhet që kontrolli të minimizojë riskun. Të gjithë kontrollet duhet të regjistrohen në **Regjistrin e Riskut**.

Monitorimi duhet të sigurojë:

1. Të gjithë aspektet e procesit të menaxhimit të riskut rishikohen të paktën një herë në vit.
2. Risqet duhen të rishikohen nga menaxheri dhe audituesi i pavarur; në Albgaz risqet kontrollohen nga drejtuesi i drejtorisë dhe nga Audit.
3. Informimi i menaxhimit për risqet e reja ose për ndryshimet në risqet e identifikuar në mënyrë që të adresohet siç duhet.

Monitorimi i riskut dhe raportimi është një proces që ndihmon menaxheret të jenë më të suksesshëm në punën e tyre.

Në këtë mënyrë situatat më negative në shoqëri monitorohen dhe kthehen në favor të institucionit. Pra kështu ne mund të përcaktojmë reagimin ndaj riskut.

IX. Strategjia e menaxhimit të riskut, fushat kryesore.

Albgaz si çdo institucion tjetër ka një sistem të **Menaxhimit Financiar**. Vëmendja kryesore e çdo hallke drejtimi dhe çdo funksion kontrolli duhet të fokusohet në përdorimin me efektivitet të fondeve buxhetore dhe menaxhim sa më të mirë të situatave financiare. Shpërdorimi i detyrës është risku më i pranishëm në çdo institucion.

Përveç gabimeve të bëra me dashje të cilat në fund të analizës mund të quhen si korrupsion ose shpërdorim i fondeve në financat e institucioneve mund të ndodhin dhe gabime pa dashje.

Për shembull: hedhja gabim e të dhënave në pasqyrat financiare kryesisht për transaksionet e veçanta të pakryera më parë.

Mosdorëzimi në kohë i pasqyrave financiare ose hedhja gabim i ndonjë të dhëne janë risqe të cilat janë të pranishëm dhe që duhen marrë në konsideratë.

Fusha e prokurimeve është një ndër fushat më me shumë risk këtu nuk duhet të ndalemi vetëm të zbatueshmëria e kuadrit ligjor por edhe zbatueshmërisë së kontratave. Dhe këtu risku nuk është vetëm financiar por dhe operacional.

- **Auditi dhe raportet e grupit të auditit.**

Grupi i auditit i Albgaz harton raportet për çdo kontroll në çdo drejtori dhe çdo njësi.

Në raportet e tyre ata paraqesin opinionet dhe vlerësimet për situatat të cilat kanë një ndikim në arritjen e objektivave. Nëse opinionet e tyre janë jo të drejta, atëherë ato sjellin një impakt negativ dhe kjo do të ulë besueshmërinë e drejtuesve të shoqërisë.

X. Objektivat e përgjithshme të Albgaz

Programi i menaxhimit, planifikimit dhe administrimit

Përshkrimi i programit	Ky program parashikon menaxhimin financiar të Shoqërisë dhe përfshin shpenzimet e nevojshme administrative për funksionimin normal të shoqërisë.
Politika e programit	Politika e këtij programi konsiston në përmirësimin e funksionimit dhe menaxhimit të Albgaz, zhvillimit të kapaciteteve menaxhuese dhe në garantimin e përmirësimit të vazhdueshëm të burimeve

	njerëzore dhe përdorimit me efektivitet të burimeve financiare të Shoqërisë.
Objektivat e politikës së programit.	▪ Përmirësimi në vazhdimësi i aftësive drejtuese të stafit të Albgaz dhe niveleve të tjera të vendimmarrjes në varësi të saj. ▪ Zhvillimi dhe zbatimi i politikave të përgjithshme për personelin. ▪ Krijimi i një institucioni eficient, ku të përmirësohen në vazhdimësi aftësitë e stafit drejtues, kapacitetet institucionale dhe teknike, me qëllim administrimin korrekt të fondeve, ▪ Organizimi i trajnimeve me stafin e ri dhe atë ekzistues, ▪ Përmirësimin e ambienteve të punës për punonjësit, ▪ Mirëmbajtja e sistemit kompjuterik dhe faqes së internetit të shoqërisë.

XI. Plani i veprimit për minimizim të riskut

Pas punës fillestare kur menaxheret identifikojnë risqet, vlerësojnë dhe caktojnë përgjegjësit duhet të hartohet një plan veprimi. Në planin e veprimit duhet të përfshihet risku, personi përgjegjës dhe koha e veprimit.

Gjithashtu në planin e veprimit duhet të përcaktohet dhe buxheti i nevojshëm për zbatimin e tij dhe mënyra e zbatimit. Më poshtë po paraqesim disa nga objektivat më të rëndësishme të shoqërisë.

Nr	Aktiviteti	Struktura përgjegjëse	Periudha
1	Rishikimi i regjistrimit të riskut duke marrë informacion nga të gjitha drejtoritë	Drejtorët e drejtorive	Gjatë vitit, 2 herë në vit.
2	Informimi i çdo drejtori menaxherial për rëndësinë e procesit të menaxhimit financiar dhe të riskut. Trajnim i stafit	Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse në bashkëpunim me drejtoritë e tjera përgjegjëse.	Gjatë vitit.
3	Përmirësimi i menaxhimit dhe përdorimit të fondeve me transparencë, efikasitet, ekonomike dhe implementimin e zhvillimit të një sistemi bashkëkohor e të qëndrueshëm për kontrollin e brendshëm financiar, me një shërbim të pavarur e funksional të auditimit të brendshëm.	Drejtoria e Financës etj.	Gjatë vitit.
4	Hartimi i buxhetit duke u mbështetur në nevojat e shoqërisë	Drejtoria e Financës	Në fund të vitit ushtrimor
5	Inventarizimi i Aseteve në administrim nga Albgaz, zgjidhja e problematikave që do të hasen, analizimi nga drejtoria.	Drejtoria Juridike Grupet e punës të ngritura për këtë proces.	Gjatë vitit.